

RAPORTI RREGULLATIV

**Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos SH.A.
Sezoni i Ngrohjes 2007/2008**

Prishtinë, 23 tetor 2007

RAPORTI RREGULLATIV

Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos SH.A.
Sezoni i Ngrohjes 2007/2008

PËRMBAJTJA

	<u>Page</u>
1. Hyrje	4
2. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore së Normës së Kthimit (RoR)	4
3. Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara	7
3.1 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Kostove Operacionale të Lejuara	8
3.2 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlersimit	15
3.3 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Profiti i Lejuar)	16
3.3.1 Formimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)	15
3.3.2 Kalkulimi Normës së Lejuar të Kthimit në Bazën e Rregulluar të Aseteve për të gjitha ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore në Kosovë	18
3.3.3 Kalkulimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Profiti i lejuar) për NQ TERMOKOS	21
3.4 Kalkulimi i të Ardhurave të Lejuara para Bashkërenditjes	22
3.5 Bashkërenditja e të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2006-2007	22
3.6 Llogaritja Finale e të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008 përfshirë edhe bashkërendimin e sezonit të ngrohjes 2006-2007	23

ANEKS

RAPORTI RREGULLATIV

Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për Ngruhtoren e Qytetit Termokos SH.A.
Sezoni i Ngruhjes 2007/2008

PËRMBAJTJA (vazhdim)

<i>Figura 1 Skema për llogaritjen e të ardhurave të lejuara</i>	<i>5</i>
<i>Tabela 1 Kostot e paraqitura nga ana e NNQ “Termokos”, dhe ato të lejuara nga ana e ZRrE-së për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, e që përfshin gjithë sezonin e ngruhjes 2007 – 2008</i>	<i>8</i>
<i>Tabela 2 RAB për NQ TERMOKOS dhe komponentet e tij për sezonin e ngruhjes 2007 - 2008</i>	<i>18</i>
<i>Tabela 3 Kthimi i Lejuar në RAB (Profit i lejuar) për NQ TERMOKOS për sezonin e ngruhjes 2007 – 2008</i>	<i>21</i>
<i>Tabela 4 Të Ardhurat e Lejuara para Bashkërendimit për për sezonin e ngruhjes 2007 - 2008</i>	<i>22</i>
<i>Tabela 5 Të Ardhurat e Lejuara për NQ TERMOKOS për sezonin e ngruhjes 2007 – 2008</i>	<i>23</i>

1. Hyrje

Në pajtim me legjislacionin themelor – nenet 46, 47, 48 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tyre në sektorin e rregulluar të energjisë; këtu janë një sërë parimesh të gjëra që kërkojnë rregulla jo diskriminuese dhe të arsyeshme me të cilat ndërmarrjet e energjisë do të mund t'i rikthenin të gjitha shpenzimet e arsyeshme përfshirë edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre.

Sektori i ngrohjes qendrore në Kosovë në bartjen dhe distribuimin e ngrohjes është klasifikuar si monopol natyror, përderisa tash për tash ende nuk ka konkurrencë për prodhimin e ngrohjes. Për këtë arsye, tarifatat për ngrohjen qendrore duhet të aprovohen nga ZRRrE-ja.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta legale, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Udhëzimin e Përkohshëm I_05_2007 “mbi “Parimet e Llogaritjes së Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”. Udhëzimi përcakton procedurat për dorëzimin dhe aprovimin e tarifave dhe metodologjinë për llogaritjen e tarifave – Norma e Kthimit (RoR) – e cila është e bazuar në të ardhurat totale të lejuara, të cilat përfshijnë shpenzimet operationale të arsyetuara, zhvlerësimin dhe kthimin e lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve.

Përcaktimi i të ardhurave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2007/2008 ka marrë parasysh si vijon:

- Informatat e dhëna nga NQ “Termokos” në aplikacionin e saj për tarifatat dhe çmimet për sezonin e ngrohjes 2007/2008;
- Informatat e dhëna nga NQ “Termokos” në raportimin e vet rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet / investimet, si dhe informatat teknike dhe ato për konsumatorë që aktualisht janë realizuar në sezonin e ngrohjes 2006/2007;
- Bashkërendimin mes tarifës së tanishme (sezoni i ngrohjes 2006/2007) dhe asaj të planifikuar (sezoni i ngrohjes 2007/2008); ky bashkërendim është bazuar në ndryshimin midis të ardhurave të planifikuara dhe atyre që aktualisht janë realizuar në sezonin e kaluar të ngrohjes të dhëna në raportimin rregullativ të NQ Termokos-it.

Shënime:

- NQ “Termokos” ka dorëzuar në ZRRrE aplikacionin për tarifa me 20 shtator 2007;
- ZRRrE-ja ka nxjerr komentet për aplikacionin për tarifa të Termokosit me 25 shtator 2007, ku kërkohej korrigjimet, shpjegime dhe informacionet / dokumente shtesë;
- Me 2 tetor, Termokosi ka ri-dorëzuar aplikacionin e përmirësuar që përmbante korrigjimet, shpjegimet shtesë dhe detalizimin e informatave të aplikacionit të tarifave;
- Bashkërendimi i lëshuar nga ZRRrE-ja me 12 shtator 2007.

2. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë së Tarifave e Normës së Kthimit (RoR)

Metodologjia e Normës së Kthimit (RoR) është zbatuar me qëllim të llogaritjes së tarifave dhe çmimeve përfshirë këtu përcaktimin e të ardhurave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2007/2008.

Parimet

Metodologjia më themelore rregullative për aprovimin e tarifave është e ashtuquajtura rregullimi “Norma e Kthimit” (ose rregullimi “kostoja plus”).

Parim bazë është se tarifa për ndërmarrjen që ofrojnë shërbime publike duhet të mbulojë shpenzimet, kështu që në njërin anë konsumatorët nuk do të duhej të paguajnë më tepër se sa kostoja e shkaktuar për ofrimin e shërbimeve, ndërsa në anën tjetër ndërmarrja e shërbimeve publike duhet të mbulojë të gjitha kostot e arsyetuara plus një normë të arsyeshme të kthimit në investimet kapitale. Çmimi total i shërbimit zakonisht përcaktohet për të përfshirë të gjitha shpenzimet operuese të

ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike, psh., të mbulojë koston e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit (operimi dhe mirëmbajtja, lënda djegëse, rrogat, shpenzimet e përbashkëta, tatimet, etj.) plus një kthim të arsyeshëm në investime dedikuara ofrimit të shërbimeve publike.

Duke qenë se rregullimi “Norma e Kthimit” nuk nxit ndërmarrjet për të ngritur efikasitetin operativ dhe të stimulojë kursimin e shpenzimeve, përkundrazi mund të nxisin mbi investime në mjetet themelore dhe gjithashtu, duke marrë parasysh obligimin e Rregullatorit për të mbrojtur konsumatorët, ajo kërkon që ndërmarrjet jo vetëm të dëshmojnë “shpenzimet e arsyeshme” të deklaruar, por edhe të tregojnë një rritje të efikasitetit operacional dhe efikasitet në blerje. Masat e tilla krijojnë bazë për bashkërendimin e tarifave në fillim të sezonit të tarifave, në të cilën rregullatori shpërblen apo ndëshkon ndërmarrjen për rritjen apo rënien e efikasitetit dhe kontrollit të koston.


Formulimi

Me qëllim të llogaritjes së të ardhurave të lejuara dhe llogaritjes përfundimtare të tarifave, metodologjia “Norma e Kthimit” (RoR) është e përfshirë në Udhëzimin e Përkohshëm I_05_2007, ku është dhënë në detaje formulimi i metodologjisë Norma e Kthimit (RoR).

Megjithatë, për arsye konsistence, formulimi do të paraqitet edhe në këtë raport.

Skematikisht, metodologjia RoR mund të tregohet si më poshtë. Shpenzimet të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga shpenzimet e veta operationale, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësojë asetet e veta, dhe kthimin në bazën rregulluese të aseteve (RAB), e cila në fakt paraqet fitimin për ndërmarrjen..

Figura 1: Skema e llogaritjes së të ardhurave të lejuara



¹Δ WC: Ndryshimi në kapitalin punues

Formulat bazë të rregullimit:

Të ardhurat e lejuara janë llogaritur sipas formulës:

$$R = OC + \text{Zhvlerësimi Vjetor} + (\text{RoR} \times \text{RAB Përfundimtar})$$

Ku:

R -	Të Ardhurat e Lejuara Totale
OC -	Kostot Operacionale të Lejuara Totale
Zhvlerësimi Vjetor	Zhvlerësimi për vitin përkatës
RoR -	Norma e Kthimit e Lejuar sipas Bazës Rregullatore të Aseteve (RAB)
RAB -	Baza Rregullatore e Aseteve
(RoR x RAB Përfundimtar)	Kthimi i Lejuar ose Profiti i Lejuar (vlerë numerike)

Të ardhurat e lejuara paraqesin koston vjetore të kompanisë, e që përbajnë: i) kostot operacionale, të cilat janë të “arsyetuara”; ii) zhvlerësimin; dhe iii) kthimin e lejuar në Bazën Rregullatore të Aseteve.

Kostot operacionale përbehen nga pjesa fikse dhe ajo variabile, e formuluar si vijon:

$$OC = OC_F + OC_v$$

Kostot operacionale paraqesin shpenzimet totale të arsyetuara të parashikuara për një vit, e që këtu hyjnë: i) shpenzimet për lëndë djegëse dhe konsumime tjera (energji elektrike, kemikalet e ujit, pjesët rezervë), si edhe humbjet e energjisë; ii) shpenzimet e sistemit operues, riparimi dhe mirëmbajtja; dhe iii) shpenzimet personale dhe të përbashkëta. Kostot operacionale të lejuara nuk përfshijnë: i) subvencionet; ii) shpenzimet e refuzuara nga autoritetet tatimore, dhe shpenzimet e ndarjes së rezervave apo shpërndarjes së tyre; dhe iii) pagesat e qirasë për mjetet që nuk janë të shënuara në llogarimbajtjen, shpenzimet financiare apo shpenzimet tjera të pa arsyetuara.

Baza Rregullatore e Aseteve është llogaritur sipas formulës:

$$\text{RAB} = \text{Vlera kontabël e Aseteve (pas Zhvlersimit kumulativ)} + \text{Investimet e reja} + \text{Kapitali Punues.}$$

Baza Rregullatore e Aseteve (RAB) paraqet asetet e ndërmarrjes të konsideruara për përdorim dhe të dobishme për shërbime publike, e të cilat përfshijnë: i) vlerën e librave kontabël (pas zhvlerësimit) ose vlerën fillestare të librave kontabël minus zhvlerësimi i akumuluar; ii) investimet e reja kur janë të planifikuara dhe të aprovuara nga rregullatori; dhe iii) kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të realizojë aktivitetet e saj.

ZRrE-ja do ta marr si Normë të Kthimit vlerën e WACC-ut (Kostoja e mesatares së ponderuar të kapitalit) për të gjitha ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë. WACC (%) është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit, dhe është llogaritur sipas formulës:

$$\text{WACC} = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]$$

Ku:

D/V -	Pjesa e borxhit nga baza totale e kapitalit
E/V -	Pjesa e ekuitetit nga baza totale e kapitalit
V -	Baza totale e kapitalit, e cila është I gjithë ekuiteti dhe borxhi

k_d	Kostoja e borxhit
k_e	Kostoja e Ekuitetit

3. Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara

Për përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara të NQ “Termokos” SH.A. për sezonin 2007/2008, në pajtim me metodologjinë e pranuar RoR, ZRRë ka ndërmarrë si vijon:

- 1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operacionale të lejuara;
- 2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
- 3) Përcaktimin e Kthimit të Lejuar në RAB (fitimi i lejuar për kompaninë), i cili përfshin:
 - a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i aseteve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi, investimet e planifikuara, dhe kapitali punues, dhe
 - b) llogaritjen e Normës së Kthimit të Lejuar (RoR)/ WACC;
- 4) Bashkëndimi i të ardhurave të lejuara aktuale dhe atyre të planifikuara për sezonin ngrohjes 2007/2008.

Në përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara, ZRRë ka marrë parasysh si vijon:

- Informatat e ofruara nga NQ ”Termokos” në aplikacionin e tij për tarifatat dhe çmimet për sezonin e ngrohjes 2007/2008 – informatën rreth të ardhurave të parashikuara nga shërbimet që kanë lidhje me ngrohjen, shpenzimet e parashikuara totale, asetet e parashikuara të cilat përfshijnë edhe investimet e planifikuara dhe rrjedhën e parashikuar të parasë, si edhe prodhimin dhe furnizimin e parashikuar të ngrohjes;
- Informatën e ofruar nga NQ”Termokos” në raportimin e tij rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet/ investimi, si edhe informatat teknike dhe për konsumatorë të cilat janë realizuar në sezonin 2006/2007;
- Informatat që ZRRë ka nga shqyrtimi i çmimeve dhe tarifave nga vitet e kaluara.

Duke e ditur se informatat e parashikuara janë kryesore për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, këto do të duhej të ishin të besueshme dhe reale. Përgjithësisht, në parashikimin / planifikimin e biznesit do të duhej të kemi qasje reale të përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve të shumtë që ndikojnë në biznesin; p.sh., vlerësimi i tregut dhe parashikimi i zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vlerësimi i prodhimit / mundësitë e furnizimit dhe mundësitë financiare të kompanisë. Natyrisht, parashikimi/planifikimi i drejtë duhet të bazohet në të dhënat që kompania i ka realizuar në të kaluarën gjatë periudhës së caktuar.

Duhet cekur këtu se, se përkundër faktit që aplikacioni për tarifa i NQ Termokos ka qenë mjaft detal, dhe më i saktë dhe më komplet se vitet e kaluara, në disa pika janë vërejtur disa mospërputhje, dhe informata jo-komplete dhe jo të sakta. Përkundër ndërhyrjes së ZRRë-së me komente në formë të kërkesës për përmirësim apo kompletim, megjithatë për disa pozicione nuk kemi marrë shpjegime të kënaqshme apo korrigjime të duhura, dhe se disa informata të përmendura më lartë shpesh kanë qenë jo-komplete, jo-reale dhe të pa mbështetura me dokumentacion përkatës – jo në pajtim të plotë me udhëzimin e raportimit rregullativ, dhe me udhëzimin për tarifatat dhe çmimet (Udhëzimet I_04_2007 dhe I_05_2007) – që ka shkaktuar vështirësi shtesë.

Në fakt, sa i përket informatave të parashikuara (përcaktuar në nenin 7.2 pika “d”), NQ “Termokos” i ka dorëzuar ZRRë-së tabelën që përshijnë të hyrat e parashikuara dhe shpenzimet mbështetur me të dhëna teknike dhe të konsumatorëve, bilansin e gjendjes të parashikuar dhe rrjedhën e parashikuar të parasë për periudhën që mbulon plotësisht sezonin e ngrohjes qendrore – 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, si dhe draftin e raportit të auditorëve për pasqyrat financiare statutoare. Edhe pas komenteve të ZRRë-së në formë të kërkesave për korrigjim, kompletim dhe shpjegime shtesë,

përsëri disa të dhëna dhe informata mbeten të pasakta dhe jo-komplete, si dhe NQ “Termokos” nuk dorëzoi raportin final të auditorëve.

Pavarësisht nga kjo, ZRrE-ja ka bërë përpjekje dhe ekspertizë për të bërë vlerësimin e informatave të parashikuara të dorëzuara nga ana e NQ “Termokos”. Është bërë një analizë e thellë dhe vlerësim i informatave të paraqitura, që është përcjellur me krahasimin e të dhënave nga sezonet e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi i saktë i të ardhurave të lejuara për sezonin që vjen 2007/2008.

3.1 Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operacionale të lejuara

Kostot operacionale të dorëzuara nga ana e NQ “Termokos” për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, periudhë kjo që mbulon gjithë sezonin e ngrohjes qendrore 2007/2008, janë strukturuar si kosto variabël dhe fikse, e cila ndarje në kuptimin e alokimit të disa pozicioneve të kostove në grupet përkatëse të kostove, nuk mund të thuhet se është në pajtim të plotë me parimet e avancuara të kontabilitetit dhe me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Në këtë seksion do të tregohen në mënyrë tabelare shpenzimet e parashikuara siç janë prezantuar nga NQ “Termokos” dhe shpenzimet operacionale të lejuara që ZRrE i ka aprovuar (Tabela 1.) Në vijim të tabelës jepet shpjegimi analitik për secilin pozicion të kostove operacionale.

Tabela 1 – Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ana e ZRrE-së për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008, e që përfshin gjithë sezonin e ngrohjes 2007/2008

Costs / Kostot		DH TERMOKOS JSC	Proposed by Propozuar nga DH Termokos	Allowed by ERO Lejuar nga ZRrE
	Variable costs:	Kostot variable		
1	Heavy oil	Mazut	4,244,100	4,075,139
2	Transport	Transporti	0	0
3	Diesel	Naftë	30,000	30,000
4	Fuel	Benzine	1,000	1,000
5	Chemicals	Kemikaljet	30,000	30,000
6	Water	Uji	60,000	60,000
7	Electricity	Energia elektrike	385,000	385,000
8	Staff costs (dir. labor)	Kost. e personelit (puna direkte)	0	262,950
9	total variable		4,750,100	4,844,089
	Fixed costs materials, services	Kostot fikse materialet/shërbimet		
10	Materials, services	Materialet, shërbimet	10,000	10,000
11	Repairs	Riparimet	40,000	40,000
12	Maintenance	Mirëmbajtja	113,000	113,000
13	Cost of small items	Shp. Materiali imte	5,000	5,000
14	Cost of cleaning	Shp. Direkte pastrim	0	0
15	Cost of office supply	Materiali zyrtar	7,000	7,000
16	Fuels	Derivate	0	0
17	Licensing Fee	Pagesa për Licensë	17,000	13,500
18	Sub-total		192,000	188,500

	Personnel costs	Shpenzimet e personelit		
19	Salaries	Pagat mujore	432,000	265,680
20	Payment BoD	Pagat e BoD	30,000	30,000
21	Food	Ushqimi	90,000	55,350
22	Transport	Transporti	26,000	15,990
23	Bonus	Bonusi	50,000	30,750
24	Pension fund	Fondi per pension	50,000	30,750
25	Experience	Përvoja	35,000	21,530
26	Sub-total		713,000	450,050
	Other costs	Shp.tjera operative		
27	Auditing	Auditimi	20,000	20,000
28	Telephone	Telefoni	12,000	12,000
29	Representation	Reprecentacioni	3,000	3,000
30	Advertising	Reklama e shpallje	1,000	1,000
31	Financial costs	Shp. Fin.	5,000	5,000
32	Municipality costs	Shp. Komunale	17,000	15,000
33	Other administration	Shp. tjera administer.	5,000	5,000
34	Computer materials	Materiale për kompjut.	6,000	6,000
35	Small items	Material I imët	15,000	15,000
36	Court & Admin. fee	Taksa gjyqësore e admin	50,000	50,000
37	Training	Trainimet	5,000	5,000
38	Others	Tjera	3,000	3,000
39	Sub-total		142,000	140,000
40	Total fixed costs	Totali i shpenzimeve fikse	1,047,000	778,550
41	Total Operational costs	Totali i shpenz. operative	5,797,100	5,622,639
42	Fixed costs	Kostot fikse	1,047,000	778,550
43	Variable costs	Kostot variabël	4,750,100	4,844,089
44	Subs. Repair & bad debts	Subv. Ripar. dhe borxhe të këqija	432,000	432,000
45	Subsidy for fuel	Subvencion për mazut	1,100,000	1,100,000
45	Allowed operational costs (OC)	Kostot e lej. oper.	4,265,100	4,090,639
46	Fixed part of OC	(OCf) Pjesa Fikse	770,309	566,419
47	Variable part of OC	(OCv) Pjesa Variab.	3,494,791	3,524,220

Technical and Customer data / Te dhenat Teknike dhe të Konsumatoreve

Heating space	m2	Sip. ngruh.	Residential	Amvisri	632,348	632,348
Heating space	m2	Sip. ngruh.	Com.&inst.	Kom Inst.	392,267	392,267
Tot. heat. Sp.	m2	Sip. Ng. tot.			1,024,615	1,024,615
Staff		Personeli			150	150
Average salary	Euro	Paga mes.			240	240
Total annual sal		Pag, vjet. tot			432,000	432,000
Product. of heat	MWh	Prodh. ngr.			141,000	132,244
Sales of heat	MWh	Shitjet e ngr.			109,762	109,762
Cons. of mazut	ton	Kons. i maz.			14,100	14,100
Price of mazut	Euro/t	Cmimi i maz.			301	290
Av. cost per ton	Euro/t	Kost.mes/ ton	9		Nuk është dhën	289.01695
Cost of mazut	Euro	Kost. e maz.			4,244,100	4,075,139

Shpjegim analitik

Shpjegimi analitik i dhënë më poshtë për secilin grup të kostove dhe për pozicionet kryesore përbërës të grupeve të veçantë të kostove, jep një shpjegim të detajizuar dhe arsyetimin për përcaktimin e kostove të lejuara.

- Kostot variabël:

- Pozicioni Nr.1 – mazuti:
 - Kostoja e mazutit e propozuar nga NQ “Termokos” (€4,244,100) është bazuar në sasinë e parashikuar të konsumit 14,100 ton dhe çmimin e blerjes prej 301 €/ton; çmimi i propozuar i blerjes është marrë nga fatura e fundit e furnizimit me mazut, që përbëhet nga çmimi i “Platts-it” (i tregut), taksa doganore, premiumi dhe TVSH-ja. ZRrE-ja konsideron se çmimi i parashikuar i blerjes duhet bazuar në ndryshimet e çmimit të tregut dhe gjithashtu nga krahasimet me çmimet e sezonëve të kaluar dhe me ndërmarrjet e tjera të ngrohjes qendrore. Çmimi i blerjes nuk përfshin TVSH-në, i cili paguhet nga kompania por i “kalohet” konsumatorit, dhe si i tillë është i kompenzueshëm. Duhet cekur se çmimi i tregut (Platts) ka shënuar rritje konstante që ka ndikuar në ngritjen e çmimit total të blerjes së mazutit. Bazuar në çka u tha më lartë ZRrE-ja vlerëson se parashikimi prej **290 €/ton për çmimin blerjes së mazutit** është i arsyeshëm edhe i justifikuar.
 - Bazuar në kërkesën e konsumatorëve për ngrohje, aftësinë e NQ “Termokos” që të plotësoj këtë kërkesë (në disa studime për sektorin e ngrohjes në Kosovë është vlerësuar 75 – 85 % – për këtë sezon ZRrE-ja ka përvetësuar 85%), duke marrë parasysh humbjet e gjenerimit dhe distribuimit, dhe bazuar në të dhënat për konsumin e lëndës djegëse, gjenerimin dhe furnizimin e ngrohjes për sezonët e mëparshëm, posaqërisht për sezonin 2006/07, ZRrE-ja vlerëson se sasia e mazutit prej 14,100 është e mjaftueshme.
 - Kostoja e mazutit e lejuar nga ZRrE-ja prej € 4,075,139 është llogaritur në bazë të sasisë së pranuar 14,100 ton dhe koston mesatare njësi të mazutit 289.01695 €/t. Llogaritja e koston së mazutit është bërë duke marrë parasysh si vijon:
 - Rezerva e mazutit në fund të sezonit 2006/07 ka qenë 563.54 tona
 - Kostoja mesatare njësi të mazutit për sezonin 2006/07 ka qenë 265.64 €/t
 - Për sa u tha më lartë për të arritur sasinë e parashikuar të konsumit të mazutit prej 14,100 ton, NQ ”Termokos” do duhet të blej sasinë:
 $14,100 - 563.54 = 13,536.46$ tona.
 - Kostoja e mazutit rezervë është: $563.54 \text{ t} * 265.64 \text{ €/t} = \mathbf{149,699 \text{ €}}$
 - Kostoja e mazutit që duhet blerë në sezonin 2007/08 është:
 $13,536 \text{ t} * 290 \text{ €/t} = \mathbf{\text{€ } 3,925,440}$
 - Kostoja e përgjithshme e mazutit për sezonin 2007/08 do të jetë:
 $149,699 \text{ €} + 3,925,440 \text{ €} = \mathbf{\text{€ } 4,075,139}$
 - Shënim: Për mbulimin e koston së mazutit, është parashikuar që Buxheti i Kosoliduar i Kosovës të japë subvencion për blerjen e mazutit në vlerë prej € 1,100,000. Vlera e subvencionuar nuk pranohet si kosto reale e kompanisë.
- Pozicioni No.2 – Transporti, Pozicioni No. 3 – Dizeli, dhe Pozicioni No.4 – Benzina janë pranuar ashtu si janë propozuar nga ana e Termokosit.
- Pozicioni No 5 – Kemikaljet
 - NQ “Termokos” ka propozuar koston për kemikalje për trajtimin e ujit në vlerë prej €30,000;
 - Duke marrë parasysh humbjet e distribuimit – rrjedhjet e ujit, dhe koston e kemikaljeve për sezonet e kaluar, ZRrE vlerëson se kostoja e propozuar është e pranueshme.

- Pozicioni No.6 – Uji i pa-trajtuar
 - NQ "Termokos" ka propozuar koston e ujit në vlerë prej €60,000
 - Duke marrë parasysh konsumin aktual të ujit prej 65,125 m³ të raportuar për sezonin e kaluar 2006-2007, konsumin e parashikuar prej 60,000 m³ për sezonin 2007-2008, dhe çmimin e ujit (tarifa volumetrike 0.60 €/m³ dhe tarifa fikse €3), jep koston e ujit në diapazon prej ca. € 36,000 - € 40,000. Megjithatë ZRrE-ja lejon që **kostoja për ujë** të jetë **€ 60,000**, siq është propozuar nga Termokosi, në mënyrë që të lejoj një kosto shtesë për një konsum eventual më të lartë, që mund të shkaktohet nga ndonjë prishje dhe rrjedhje të ujit të pa parashikuar.

- Pozicioni No 7 – **Kostoja e rrymës elektrike** është pranuar siq është propozuar nga Termokosi në vlerë prej **€385,000**

- Pozicioni No. 8 – Kostoja e Personelit ("puna direkte")
 - Në dorëzimin e parë NQ "Termokos" nuk ka paraqitur koston e personelit – "puna direkte", por ka dorëzuar koston totale të personelit në vlerë prej €713,000, e cila ishte alokuar në koston fikse. Mandej, pas kërkesës së ZRrE-së, Termokosi ka paraqitur €435,000 për koston e personelit – "puna direkte" dhe €278,000 për koston e personelit në administratë, shitje dhe në departamentet tjera (tjetër nga "puna direkte"). Kjo është një ndarje paksa e pazakonshme e koston së personelit me proporcion 61% të "punës direkte" ndaj 39% të koston së personelit tjetër nga "puna direkte", që është e kundërt me proporcionin e paraqitur në sezonët e kaluar.
 - Pasi që Termokosi ka paraqitur raport (proporcion) të kundërt se sezonin e kaluar, dhe vetëm ndarjen e përgjithshme të koston së personelit, koston janë llogaritur proporcionalisht për koponentët më poshtë, duke përdorur raportin e sezonit të kaluar (38.5% - "puna direkte" ndaj 61.5% - kostoja e personelit për departamentet tjera). Në përputhje me proporcionin e lartë përmedur, ZRrE-ja ka alokuar koston e personelit "puna direkte" dhe ka llogaritur komponentet përbërës si vijon:

Kostoja e Personelit ("puna direkte):

- pagat	166,320
- ushqimi	34,650
- transporti	10,010
- bonusi	19,250
- fondi pensional	19,250
- eksperienca	13,470
Total	262,950

Sa për më lartë ZRrE-ja pranon **koston e personelit – puna direkte** në vlerë prej **€262,950**.

Kostot totale variabile të pranuar nga ZRrE-ja si të arsyeshme janë **€4,844,089**, që është për €93,989 më shumë se kostot variabël të propozuara nga NQ "Termokos" (€4,750,100). Kjo për shkak të alokimit të ndryshëm të koston së personelit siq është përmendur më lartë. Kostot variabile totale të pranuar janë gjithashtu dukshëm më të larta, për € 1,034,112, sesa kostot aktuale variabël siq janë vendosur nga ZRrE-ja për sezonin e ngrohjes 2006/2007 (€3,809,977). Kjo rritje e kostove variabile është kryesisht për shkak të konsumit dhe koston më të lartë të mazutit që ZRrE-ja ka vendosur (lejuar) për shkaqet e përshtuara nën pozicionin Nr.1 më lartë, në mënyrë që Termokosi të përmirësoj kualitetin e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit me ngrohje.

- Kostot fikse

- Grupi i kostove – Materialet dhe shërbimet:

- Pozicioni Nr.10 – Materialet dhe Shërbimet (pjesët rezervë), është pranuar siq është propozuar nga NQ”Termokos” në vlerë prej €10,000, pasi që paraqet një zvogëlim shumë të vogël prej €1,000 nga ç’është propozuar dhe pranuar në aplikimin e fundit të tarifave (sezoni 2006-2007).
- Pozicioni Nr. 11 – Riparimet, dhe Pozicioni Nr.12 – Mirëmbajtja janë pranuar siq janë propozuar nga NQ”Termokos” në vlerë prej €40,000 respektivisht €113,000. Edhe pse këto kosto të propozuara janë më larta se ato që aktualisht janë realizuar në sezonin 2006/07, ZRrE-ja i ka pranuar në mënyrë që NQ”Termokos” të përmirësoj shërbimin ndaj konsumatorit mirëmbajt mirë sistemin e ngrohjes qendrore dhe në kohë e me kompetencë të eliminoj prishjet eventuale.
- Pozicionet Nr. 13 – 16 janë pranuar siq janë propozuar nga Termokosi.
- Pozicioni Nr.17: Pagesa për Licensë është propozuar nga Termokosi në lartësinë € 17,000, e cila shumë nuk korrespondon me gjenerimin e parashikuar të ngrohjes të paraqitur prej tyre. Bazuar në llogaritjet tona të gjenerimit të ngrohjes (132,244 MWh) dhe në listë e pagesave për licensë të adoptuar dhe lëshuar nga Bordi i ZRrE-së, është pranuar **kostoja e pagesës për licensë** në vlerë prej ca. **€13,500**.

- Grupi i Kostove – Kostoja e Personelit (e ndryshme prej”punës direkte”)

- Pozicioni Nr. 19 – Pagat
 - Kostoja e pagave prej €265,680 është llogaritur sipas proporcionit të përshkruar nën pozicionin Nr. 8.
Shënim: Pagat totale të kompanisë (puna direkte dhe departamentet tjera) janë €432,000, që përputhet me llogaritjen për numrin e personelit 150 dhe pagën mesatare mujore prej €240.
 Edhe pse është vërejtur një rritje e vogël e numrit të punësuarve (nga 147 në sezonin e fundit në 150 e parashikuar për 2007/08), dhe pasi që kostoja e personelit përafërsisht përputhet me koston aktuale të pagave të raportuar për sezonin 2006/07, ZRrE-ja ka vendosur të pranon koston totale të pagave siq është propozuar nga NQ Termokos në vlerë prej € 432,000, por me alokim të ndryshëm (pagat – “puna direkte”: €166,320, dhe pagat – departamentet tjera: €265,680).
- Pozicioni Nr.20 Pagesa për anëtarët e Bordit të Termokosit, është pranuar siq është propozuar nga kompania në vlerë prej € 30,000
- Pozicioni Nr. 21 – kostoja për ushqim
 - Kostoja e ushqimit, e llogaritur sipas proporcionit të përmendur më lartë është €55,350;
Shënim: Kostoja e ushqimit për tërë personelin e kompanisë është €90,000, që është llogaritur për 150 punëtorë që marrin nga €50/month.
 - Edhe pse është vërejtur një rritje shumë e vogël nga viti i kaluar (nga €81,000 në €90,000), ZRRE-ja ka vendosur të pranohet koston e ushqimit siq është paraqitur nga NQ Termokos, por me alokim të ndryshëm: kostoja e ushqimit – puna direkte: €34,650, dhe kostoja e ushqimit – departamentet tjera: €55,350.
- Pozicioni Nr. 22 Transporti është pranuar siq është propozuar nga Termokosi, por me alokim të bazuar në proporcionin e përshkruar më lartë: transporti – puna direkte: €10,010, dhe transporti – departamentet tjera: €15,990

- Pozicioni Nr. 23 – bonusi, është pranuar siq është propozuar nga Termokosi, por me alokim të ndryshëm: bonusi – puna direkte: €19,250 dhe bonusi – departamentet tjera: €30,750.
- Pozicioni Nr. 24 – Fondi pensional (kontributi i paguar nga kompania)
 - Kosto për kontributin për pension e llogaritur sipas proporcionit të përmendur më lartë është €30,750;
 - Shënim: Kostoja totale e kompanisë për kontributin pensional është €50,000, shumë kjo që është në përputhje me rregulloren për kontributin pensional, ku thuhet se 5% e pages paguhet nga kompania; vlera e koston për kontributin pensional e llogaritur si 5% e shumës totale të pagave përputhet me koston e propozuar nga kompania, dhe si e tillë është e pranueshme për ZRrE-n.
- Pozicioni Nr. 25 Eksperienca pranohet siq është propozuar nga Termokosi, por me alokim të ndryshëm të bazuar në proporcionin e lartëpërmendur: eksperienca – puna direkte: €13,470, dhe eksperienca – departamentet tjera: €21,530.

- Grupi i kostove – Kostot tjera fikse

- Grupi Kostot tjera fikse që përmban pozicionet Nr. 27 – Nr. 38 janë pranuar siq janë propozuar nga Termokosi, me përjashtim të pozicionit Nr. 32: Kostot komunale. Kostot komunale janë zvogëluar për €2,000 – nga të propozuara € 17,000 në të pranuar € 15,000, sepse sezonin e kaluar janë propozuar dhe pranuar €15,000 si kosto komunale dhe NQ “Termokos” nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi, e poashtu ZRrE-ja nuk është në dijeni, për ngritje të çmimeve respektive të komponenteve (tatimi në prone, shërbimet e mbeturinave dhe ujrave të zeza etj.) që përmbajnë të ashtuquajturin kosto komunale. Si për më lartë, kostot e pranuar nga ZRrE-ja të grupit “kostot tjera fikse” japin shumën e përgjithëshme €140,000.

Shënim : Përveq komponenteve të zakonshme të listuara nën grupin “kostot tjera”, këtë sezonë NQ Termokos ka shtuar edhe koston e auditimit dhe taksat gjyqësore e administrative. Këto janë pranuar siq janë propozuar me vërejtje se këto kosto do të verifikohen veqanërisht gjatë raportimit regullativ të ardhëshëm.

Kostot fikse totale të pranuar nga ZRrE-ja si të arsyeshme janë në lartësinë prej **€778,550**, që është dukshëm më pak se sa është propozuar nga Termokosi (€ 1,047,000). Ky ndryshim është kryesisht për shkak të alokimit të ndryshëm të koston së personelit siq është përshkruar në paragrafët më lartë nën grupin e kostove “kostoja e personelit”. Kostot fikse të pranuar janë pothuaj të njëjta me kostot fikse aktuale të raportuara dhe të vendosura nga ZRrE-ja për sezonin e ngrohjes 2006/2007 (€ 778,260). Kjo vlerë e lejuar mendohet se do ti mbuloj të gjitha kostot e arsyeshme fikse të kompanisë duke supozuar se Termokosi do ta përmirësoj shërbimin ndaj konsumatorëve duke mirëmbajtur sistemin në mënyrë të rregullt, të parandaloj prishjet në sistemin e ngrohjes, dhe me kohë të reagoj në evitimin dhe riparimin e prishjeve eventuale. Shpenzimet fikse të lejuara gjithashtu është menduar të mbulojnë shpenzimet që kanë të bëjnë me përprjekjet e shtuara në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të kompanisë, përmirësimin e sistemit të kontabilitetit, krijimin e sistemit të informimit dhe raportimit të menaxhmentit, dhe si më e rëndësishmja rritjen e arkëtimit të pagesave e po ashtu edhe zbulimin dhe parandalimin e kycjes ilegale/furnizimit ilegal me ngrohje.

- Shpenzimet operationale të lejuara

Shpenzimet operationale të lejuara përbëhen nga shuma e shpenzimeve fikse dhe atyre variabël dhe nuk përfshijnë vlerën e subvencioneve.

NQ "Termokos" ka paraqitur **subvencionin për lëndë djegëse (mazut)** në vlerë prej **€1,100,000**; kjo vlerë paraqet një sasi të caktuar të shpenzimeve totale të mazutit, që planifikohet të dhurohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Më tutje NQ "Termokos" ka paraqitur vlerën e **subvencionit për investime** – kryesisht për riparime në vlerë prej **€300,000**, dhe **subvencionin për borxhe të këqija** në vlerë prej **€132,000**.

Shuma **totale e subvencioneve** në vlerë prej **€1,532,000** është pranuar nga ZRrE-ja ashtu siq është paraqitur nga NQ "Termokos".

Vlera e subvencionuar nuk është pranuar si shpenzim real i kompanisë dhe si e tillë nuk mund të përfshihet në kostot e lejuara operacionale.

Shpenzimet operacionale të lejuara janë llogaritur sipas formulës së shënuar më poshtë:

OC = Kostot Variabile + Kostot Fikse – Subvencionet

Nga formula llogaritet:

Shpenzimet operacionale të lejuara në vlerë prej €4,090,639.

Kjo vlerë paraqet kostot operacionale totale të lejuara nga ZRrE-ja, shumë kjo e cila është për €174,461 më e vogël se shuma e propozuar nga NQ "Termokos" (€4,265,100). Pamëvarsisht nga kjo, kostot e lejuara operacionale janë përsëri shumë më të mëdha, për €1,235,249, se sa kostot aktuale operacionale sipas vendimit të ZRrE-së për sezonin e ngrohjes 2006/2007 (€2,855,390). Kjo rritje e kostove operacionale të lejuara është kryesisht për shkak të parashikimit më të madh të konsumit dhe kostos së karburantit se sa në sezonin e fundit, si dhe për shkak të vlerës më të vogël të subvencioneve të parashikuara për këtë sezon (në sezonin 2006/2007 vlera aktuale e subvencionit për karburant ishte €1,732,867 plus subvencioni për investime në vlerë prej ca. €500,000, që jep shumën totale ca €2,233,000; përderisa këtë sezon subvencionet janë planifikuar të jenë €1,532,000).

Ndarja e kostove totale operacionale të lejuara është paraqitur më poshtë:

Pjesa fikse e kostove operacionale të lejuara (OCf) është €566,419; dhe Pjesa variabël e kostove operacionale të lejuara (OCv) është €3,524,220.

Përveq kostove operacionale të paraqitura më lartë, NQ Termokos ka paraqitur, gjithashtu si shpenzim, edhe **provizionin e borxheve të këqija** në vlerë prej **€ 1,324,000**, që është mbështetur me shpjegim të pamjaftueshëm që thot se sipas vendimit të Bordit të kompanisë, faturat be pa-arkëtuara për një afat të caktuar duhen të zbriten nga llogaritë e arkëtueshme dhe të paraqiten si provizion i borxheve të këqija.

Në lidhje me këtë ZRrE-ja ka konsultuar rregulloren 2002/3 mbi tatimin në fitim e cila i merr parasysh dhe pranon provizionin e borxheve të këqija si shpenzim nëse janë përmbushur kushtet si në vijim:

- a) Nëse shuma që korrespondon me provizionin e borxheve të këqija përfshihet në të ardhura,
- b) Nëse këto borxhe shlyhen nga librat e kontabilitetit sit ë pavlefshme, dhe
- c) Nëse ekziston prova e evidente se janë bërë përpjekje të pa suksesshme për arkëtimin e borxheve (evidence nga gjykatat – ngritja e padinave etj.)

Rrjedhimisht ne kërkuam nga Termokosi prova lidhur me përmbushjen e kushteve të mësipërme. Sipas kërkesës sonë ata ofruan si në vijim:

- Padinat e ngritura në gjykata në vitin 2006 dhe 2007 në vlerë totale prej € 354,005:
 - i) 57 padina në vitin 2006 në vlerë prej € 84,700

ii) 600 padina në vitin 2007 në vlerë prej € 269,305

- Kërkesat e dorëzuara në AKM kundër NSH-ve në likuidim në shumë totale €314,042
Pra, shuma totale për të cilën është marrë ndonjë veprim ligjor është € 668,047.

ZRrE-ja dëshiron edhe njëherë të proklamoj parimet bazë të metodologjisë tarifore dhe rregullimit të çmimeve, sipas të cilave borxhet e këqija nuk konsiderohen si kosto të arsyeshme. Megjithatë, duke marrë parasysh rrethanat në kuptimin e vështirësive për arkëtimin e pagesave/borxheve dhe sistemin gjyqësor jo-efikas, ZRrE-ja shpreh vullent për të pranuar një pjesë të arsyeshme të provizionit të borxheve të këqija të llogaritur si vijon:

- Shuma totale për të cilën është ndërmarrë ndonjë veprim ligjor është € 668,047
- Duke supozuar se 50% e shumës së cekur më lartë nuk do të ekzekutohet (nuk do të kthehet Termokosit), ZRrE-ja e pranon e shumën e barabartë me $50\% * 668,047 = €334,024$

Pra ZRrE-ja e pranon **Provizionin e borxheve të këqija (BDP)** në shumën € **334,024**, duke theksuar se kjo nuk është plotësisht në përputhje me parimin bazë të rregullimit, dhe nuk duhet të jetë presedan për shqyrtimet e ardhshme të çmimeve dhe për kompanitë tjera të ngrohjes qendrore. Për qëllim të përfshirjes në të Ardhurat e Lejuara, pozicioni provizioni I borxheve të këqija do t'i shtohet Kostove operacionale të lejuara.

3.2 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit

NQ TERMOKOS ka paraqitur në aplikimin për tarifa zhvlerësimin vjetor të parashikuar prej €863,000 për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008. Pasi që nuk është paraqitur llogaritja detale e zhvlerësimit, ZRrE-ja ka përcaktuar zhvlerësimin vjetor bazuar në vlerësimet e mëposhtme. Në ndërkohë ne e inkurajojmë NQ TERMOKOS-in të na paraqet sa më shpejt të jetë e mundur llogaritjen detale të zhvlerësimit vjetor dhe kumulativ.

Bazuar në eksperiencën e kaluar, zhvlerësimi është llogaritur në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/3 e cila parasheh tri kategori të zhvlerësimit:

- Ndërtesat dhe struktura e përherëshme – (5%)
- Pajisjet, automjetet dhe kamionët e lehtë, kompjuterët, pajisjet tjera ndihmëse dhe pajisjet për procedimin e të dhënave, inventari i zyrës dhe pajisjet, instrumentet, gjëra të ndryshme dhe pajisje shtesë – (20%).
- Objekti dhe makineria, mjetet e rënda të transportit, pajisjet për kryerjen e punëve të dheut, mjetet tjera të rënda, dhe të gjitha asetet tjera të prekshme – (15%).

ZRrE-ja ka vlerësuar zhvlerësimin vjetor për sezonin e ngrohjes 2006-2007 dhe në bashkërendimin final është definuar në €672,146. Ne supozojmë se për sezonin e ngrohjes 2007-2008 nuk do të ketë ndonjë tjetërsim të aseteve të investuara; dhe asnjë investim tjetër nga ai që është në RAB-in përfundimtarë, në fund të sezonit 2006-2007 nuk ishte zhvlerësuar tërësisht. Me këtë ne mund ta marrim të njëjtin zhvlerësim për investimet ekzistuese për sezonin e ngrohjes 2007-2008 si ai për sezonin 2006-2007, e që është €672,146. Ne i shtojmë 15% zhvlerësim në investimet e reja prej €528,706 nga sezoni I ngrohjes 2006-2007, që është i barabartë me €79,306; dhe do të shtojmë edhe zhvlerësimin në investimet e reja të planifikuara për sezonin e ngrohjes 2007-2008, në vlerë prej €455,500. Bazuar në informatat nga TERMOKOS-i këto investime do të financohen nga burimet e vet kompanisë pa asnjë donacion, dhe kryesisht bien në kategorinë e makinerisë dhe paisjeve, që ka një zhvlerësim vjetor 15% ose shumën ekuivalente prej $€455,500 * 15\% = €68,325$. Në total ne fitojmë **zhvlerësimin vjetor për sezonin e ngrohjes 2007-2008** si më poshtë:

$$€672,146 + €79,306 + €68,325 = €819,777$$

3.3 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)

Siç u përmend më parë, llogaritja/përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB përfshin:

- formimin (vendosjen) e Bazës Rregulluar të Aseteve (RAB); dhe
- llogaritjen e Normës së Kthimit të lejuar (RoR), të përcaktuar në vlerën e WACC.

Këto dy element të rëndësishme do të llogariten detalisht si më poshtë.

3.3.1 Vendosja e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)

Vendosja e RAB-it përfundimtar është faktori kryesor për llogaritjen e profitit të lejuar të kompanisë. RAB-i përfundimtarë përbahet nga vlera kontabël e asetëve fikse, investimet e reja të planifikuara dhe kapitali punues.

3.3.1.1 Përcaktimi i Vlerës së Aseteve Ekzistues Fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar)

NQ TERMOKOS ka paraqitur ZRrE-së vlerën e parashikuar të asetve fikse pas zhvlerësimit të akumuluar në bilansin e parashikuar të gjendjes 2007 – 2008, në shumë prej €8,541,957, e cila vlerë reflekton vlerën e asetëve fikse siq ishte deklaruar në bilansin e gjendje të 31 dhjetorit 2006 të raportit të auditorëve. Për këtë ZRrE-ja vendos të merr vlerën kontabël të asetëve fikse pas zhvlerësimit të akumuluar si në bashkërendimin për sezonin e ngrohjes 2006-2007 të lejuar nga ZRrE-ja, e cila ishte €8,458,703. ZRrE-ja do të shtoj investimet e reja siq janë përmendur në bashkërendimin për sezonin 2006-2007, që është €528,706, pra totali i asetëve fikse neto në fund të 2006 - 2007 definohet në €8,987,409. Nga kjo shumë ZRrE-ja do të zbres zhvlerësimin vjetor për sezonin e ngrohjes 2006-2007, që është €672,146, dhe 15% i €528,706 investime të reja në shumë €79,306, ose në total €751,452. Rrjedhimisht, **vlera finale kontabël e asetëve fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar)**, është definuar në vlerën €8,987,409 - €751,452 = **€8,235,957** për sezonin e ngrohjes 2007-2008.

3.3.1.2 Përcaktimi i Investimeve të reja

NQ TERMOKOS ka paraqitur në pasqyrën e rrjedhjes së parasë të parashikuar dhe në bilansin e parashikuar të gjendjes për periudhën 15 tetor 2007 - 14 tetor 2008, investimet e reja të planifikuara në vlerë prej €755,500. Sipas kërkesës sonë Termokosi dha shpjegimin ku janë listuar projektet investive me vlerat përkatëse investuese, por pa detajet tjera siq janë specifikimi I burimeve të financimit – në vetë-financim dhe donacion, si dhe nuk ka dhënë fizibilitetin financiar dhe teknik të projekteve investive. Megjithatë NQ Termokos, në pasqyrat e parashikuara ka deklaruar se do të marrë €300,000 nga donacionet për të realizuar këto investime. Rrjedhimisht ZRrE-ja mund marrë në considerate të vetë shumën €755,500 minus €300,000, që është e barabartë me **€455,500** si **investime të reja** për tu përfshirë në Bazën e rregulluar të asetve (RAB) për sezonin e ngrohjes 2007-2008.

3.3.1.3 Përcaktimi i Kapitalit Punues

NQ TERMOKOS nuk ka paraqitur Kapitalin punues të llogaritur, por ka paraqitur tek ZRrE-ja bilansin e parashikuar të gjendjes për periudhën 15 tetor 2007 – 14 tetor 2008; ZRrE-ja ka analizuar asetet korrente dhe detyrimet korrente dhe ka llogaritur kapitalin punues si më poshtë:

Bilansi i Gjendjes i Parashikuar

Në €

Asetet Korrente

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	103,301
Logaritë e Arkëtueshme e tjera	3,007,515
Stoqet	978,638
Parapagimet	1,998,476

Total Asete Korrente **6,087,930**

Në €

Detyrimet Korrente

Llogaritë e pagueshme	3,600,282
Të pagueshmet për tatim	1,805,000

Total Detyrime Korrente **5,405,282**

Kapitali Punues **682,648**

Siq u tha më lartë kapitali punues nuk ishte llogaritur dhe raportuar në aplikimin për tarifa të NQ TERMOKOS-it dhe bazuar në bilansin e parashikuar të gjendjes **Kapitali Punues** është **€682,648**. Kjo shumë do të merret si objektiv për kapitalin punues për sezonin e ngrohjes 2007-2008, për qëllim të llogaritjes së bazës së rregulluar të aseteve (RAB).

Baza Rregullatore e Aseteve (RAB) llogaritet si vijon:

RAB = Vlera Kont. e Aseteve (pas zhvler.) + Invest. e Reja + Kapitali Punues
Dhe që rezulton siq është në tabelën 2, në vlerë prej € 9,347,105.

Në Tabelën 2 më poshtë ne përmbledhim komponentet e RAB-it përfundimtarë dhe vlerën respektive.

Tabela 2: RAB-i përfundimtarë i NQ TERMOKOS dhe komponentet e tij për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008

Baza e Rregulluar e Aseteve - NQ TERMOKOS Për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008		In €	
		Propozuar nga DHC /NQ TERMOKOS	Allowed by ERO Lejuar nga ZRRrE
3.3.1.1	Vlera kontabël e asetëve fikse (pas zhvlerësimit të akumuluar)	8,541,957	8,235,957
3.3.1.2	Investimet e Reja	755,500	455,500
3.3.1.3	Kapitali Punues	682,648	682,648
	Baza e Rregulluar e Aseteve	9,980,105	9,374,105

3.3.2 Llogaritja e Normës së Kthimit të Lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve për të gjitha Kompanitë e Ngrhjes Qendrore në Kosovë

Objektivi i Normës së Kthimit të arsyeshme (RoR) në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), është të garantoj ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për një fitim që lejon të vazhdohet me investimet në asete, në mënyrë që të mund ti zavendësoj dhe zgjeroj ato.

Një "Normë e Kthimit" (RoR) I arsyeshëm konsiderohet të jetë norma e "Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit" (WACC), që llogaritet në bazë komponenteve të bazës së kapitalit, duke marrë parasysh ponderimet e shumave të këtyre komponenteve të kapitalit. Me fjalë tjera, WACC-u është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit.

Për koston e ekuitetit, ZRRrE-ja ndjek metodologjinë e njohur ndërkombëtare të quajtur "Modeli I Çmimit të Kapitalit të Aseteve" (CAPM). CAPM shpreh koston e pritur të ekuitetit si një normë pa rrezik (r_f) plus premiumin e rrezikut të ekuitetit (ERP). Ne mund ta definojmë ERP si ndryshimin mes rrezikut të tregut të ekuitetit – d.m.th. kthimi I pritur nga tregu I zhvilluar mirë – dhe normën e kthimit pa rrezik, e që shprehet me formulën e paraqitur më poshtë:

$$ERP = (r_m - r_f)$$

Norma e ERP varet nga rreziku I investimit në një treg të një vendi të veçant.

Vlera e WACC-ut para tatimeve mund të llogaritet sipas formules në vijim:

$$WACC_{pre-tax} = [(D/V)*k_d] + [(E/V)*k_e]$$

ku:

D/V Raporti i borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)

E/V	Raporti i ekuitetit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
V	Totali i bazës së kapitalit, që është shuma e ekuitetit dhe borxhit
k_d	Kostoja e Borxhit
k_e	Kostoja e ekuitetit

Kostoja e borxhit (k_d) është zotim kontraktual dhe është norma që ndërmarrja paguan në huatë e marruna në të ardhmen, dhe shprehet sipas formules:

$$k_d = r_f + d_{rp}$$

Ku:

r_f	Norma pa rrezik
d_{rp}	Premiumi i rrezikut të borxhit

Kostoja e ekuitetit (k_e) llogaritet si në vijim:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

Ku:

r_f	Norma pa rrezik, nxjerret nga vlerësimet për kthimin në obligacionet (“bondet” e qeverisë)
β_e	“Beta”: masa e rrezikut për kompaninë përkatëse
(r_m - r_f)	Premiumi i rrezikut të tregut të ekuitetit minus norma e kthimit pa rrezik

“Premiumi i rrezikut” është përcaktuar nga “beta” dhe nga premiumi i rrezikut të pritur të një tregu, e që investitorët e kërkojnë nga tregu si tërësi. Faktori “beta” matë pa-parashikueshmërinë e kthimit të një kompanie në relacion me tregun e mallrave (aksoneve) si tërësi.

Më poshtë ne vlerësojmë/llogarisim koston e borxhit dhe koston e ekuitetit për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë, për të ardhur tek WACC para tatimeve.

3.3.2.1 Kostoja e Borxhit

Rezultatet e mëparshme për raportin e borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit për NQ TERMOKOS dhe NQ GJAKOVA gjatë sezonit të ngrohjes 2005-2006 janë bazuar nga të dhënat financiare që kemi marrë dhe definohet në 50% dhe 73% respektivisht.

Për këtë sezon të ngrohjes dhe ata vijues, ZRRë-ja ka vendosur që raporti D/V të jetë në mes të 50% dhe 73% dhe e vendos në vlerën 60/100% (60% borxh dhe 40% ekuitet). Ky raport 60% duhet të përdoret në vlerësimet /llogaritjet e WACC-ut komercial para tatimeve për kompanitë e ngrohjes qendrore në Kosovë për sezonin e ngrohjes 2006 – 2007 dhe sezonët vijues.

Kthimi në borxh paraqitet sipas formules më poshtë:

$$k_d = r_f + d_{rp}$$

Ku:

r_f	Norma pa rrezik
d_{rp}	premiumi i rrezikut të borxhit

Sa i përket normës pa rrezik të borxhit (d_f) ne supozojmë se nëse qeveria e Kosovës do të emitonte obligacione (bonde), fillimisht do kishte normën e interesit më të ulët se sa të investimeve. Ne supozojmë se kjo do rangohej më poshtë se Ukraina dhe Turqia, që të dyja kanë rangimin e kreditit BB-. Pra duket e arsyeshme që të marrim për Kosovën një **normë reale pa rrezik të borxhit 5.5%**, që është mes mesatares së Ukrainës dhe Turqisë, dhe asaj të Argjentinës.

Nga disa shembuj të Autoriteteve rregullative të BE dhe Australisë, premiumi i rrezikut të borxhit (d_p) vlerësohet në rangun prej 0.84 dhe 1.75%. Duke marrë parasysh rrezikun e lartë për shkak të mos-pagesës bashkë me performancën ekonomike të dobët të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në Kosovë, ne e vlerësojmë d_p për Kosovë më lartë dhe e vendosim në **2.5%**.

Kostoja e borxhit pastaj llogaritet si më poshtë:

$$k_d = 5.5\% + 2.5\% = 8\%$$

3.3.2.2 Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e ekuitetit paraqitet me formulën më poshtë:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:

$$ERP = (r_m - r_f)$$

Vendimet e fundit të autoriteteve rregullative e vlerësojnë premiumin e rrezikut në ekuitet në rangun prej 3.5 gjer 7%, me një mesatare prej 5.0%. Ne propozojmë të merret **ERP-ja për Kosovë e barabartë me 6%**.

Beta mesatare e aseteve për rrjetet e energjisë elektrike në BE dhe për ndërmarrjet e integruara është 0.42 e krahasuar me 0.54 - 0.63 për ndërmarrjet që kanë vetëm gjenerimin dhe furnizimin në BE dhe SHBA. Për shkak se industria e ngrohjes qendrore në Kosovë është e vogël, duket e arsyeshme që të supozojmë se rritja e kërkesës – që është faktori kryesor për rritjen e të ardhurave – do të jetë më e pa-parashikueshme se sa rritja e GDP – që është faktori kryesor për rritjen e tregut të mallrave dhe akcioneve – se sa në vendet e mëdha dhe të zhvilluara. Shtimi i një konsumatori të vetëm të madhë në ngrohjen qendrore do të thotë rritjen e kërkesës për ngrohje qendrore në krahasim me kërkesën e mëparme, përderisa ndikim në GDP mund të jetë shumë më i vogël. Në mënyrë që ta marrin në konsideratë natyrën më të pa-parashikueshme të të ardhurave të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në krahasim me rritjen e GDP, ne vlerësojmë që kostoja e ekuitetit të jetë më e lartë se sa mesatarja e vendosur nga rregullatorët e BE-së, dhe ne konsiderojmë se “ β_e ” e arsyeshme për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë si më poshtë:

$$\beta_e = 1$$

Kostoja e ekuitetit pas tatimeve është si në vijim:

$$k_{e \text{ post tax}} = 5.5\% + (1 * 6\%) = 11.5\%$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve gjendet duke shumëzuar rezultatin më lartë të koston së ekuitetit pas tatimeve me relacionin që e konsideron tatimin (“tax wedge”) si më poshtë:

$$\text{Tax wedge} = 1/(1-t)$$

ku:

t Shkalla e tatimit në fitimin e kompanive

Tatimi në fitim (t) në Kosovë është 20% dhe relacioni që e konsideron tatimin (“tax wedge”) është:

$$1/(1-0.20) = 1.25$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve është:

$$k_{e \text{ pre-tax}} = 11.5\% * 1.25 = 14.4\%$$

Si rrejdhim i llogarive më lartë llogaritet WACC-u para tatimeve – I rrumbullaksuar në një decimale – si më poshtë:

$$\text{WACC}_{\text{pre-tax}} = [8\% * 0.6] + [14.4\% * 0.4] = 10.6\%$$

3.3.3 Llogaritja e Kthimit të Lejuar në RAB (Profiti të Lejuar) për NQ TERMOKOS

Bazuar në $\text{WACC}_{\text{pre-tax}}$ e llogaritur prej 10.6% si në 3.3.2, ne jemi në gjendje të llogarisim Kthimin e Lejuar apo Profitin e Lejuar për NQ TERMOKOS, i cili sipas formulës më poshtë:

$$(\text{RoR} \times \text{Closing RAB})$$

Është i barabartë me $€9,374,105 * 10.6\% = €993,655$.

Tabela 3: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB për NQ TERMOKOS për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008

		In €	
Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RAB për NQ TERMOKOS për sezonin e ngrohjes 2007 - 2008		Proposed by Propozuar nga DHC/NQ TERMOKOS	Allowed by ERO Lejuar nga ZRrE
CLOSING RAB	Baza e Rregulluar e Aseteve	9,980,105	9,347,105
RoR	Norma e Kthimit në vlerën e WACC	10.6 %	10.6 %
	Kthimi i Lejuar ose Profiti i Lejuar	1,057,891	993,655

3.4 Llogaritja e të Ardhurave të Lejuara para Bashkërendimit

Të Ardhurat e lejuara totale para bashkërendimit janë llogaritur sipas formulës:

$R_{bRec} = OC + \text{Zhvlerësimi Vjetor} + \text{Kthimi i Lejuar në RAB}$, dhe është e barabartë me € 6,238,095, siq paraqitet detalisht në tabelen 4.

Tabela 4: Kthimi i Lejuar para Bashkërendimit për sezonin e ngrohjes 2007-08

In €

Të Ardhurat e Lejuara para Bashkërendimit NQ TERMOKOS për sezonin 2007 – 2008		Proposed by DHC TERMOKOS	Allowed by ERO
OC	Kostot Operacionale të Lejuara	4,265,100	4,090,639
BDP	Provizioni i borxheve të këqija	1,324,000	334,024
	Zhvlerësimi	863,000	819,777
	Kthimi i Lejuar në RAB	1,057,891	993,655
R_{bRec}	Të Ardhurat e Lejuara para Bashkërendimit	7,509,991	6,238,095

3.5 Bashkërendimi i të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2006 - 2007

Bazuar në Bashkërendimin e llogaritur nga ZRrE-ja siq është dhënë nga “Vlerësimi I Raportimit Rregullativ të Ndrohtores së Qytetit TERMOKOS SH.A. – Krahasimi I të dhënave aktuale dhe të planifikuara për sezonin e ngrohjes 2006/2007” të nxjerrur në shtator 2006, që në fakt është ndryshimi i pranuar nga ZRrE-ja në mes të Ardhurave të Lejuara aktuale dhe të planifikuara për sezonin e ngrohjes 2006-2007, **€721,780 do të zbriten** nga të Ardhurat e Lejuara për sezonin e ngrohjes 2007/08. Por ne gjithashtu duhet të zbrisim shumë e bashkërendimit për sezonin e ngrohjes 2004- 2005, e cila shumë është shpërndarë për pesë vite dhe paraqet një të pestën e €1,407,867 ose €281,573 pa interes. Ne ja shtojmë interesin vjetor prej 3.9%, që është I barabartë me interesin për depozitim të parave në bankat e Kosovës, e që **shuma që zbritet për shkak të bashkërendimit 2004-2005 do të jetë: €281,573 * 1.039= €292,554**. Kjo pra është një e pesta e tretë e bashkërendimit 2004 -2005 me shkallë të interesit, që hiqet nga të ardhurat e lejuara për sezonin e ngrohjes 2006 - 2007.

3.6 Llogaritja Finale e të Ardhurave të Lejuara për sezonin e ngrohjes 2007-2008 përfshirë bashkërendimin e sezonit të ngrohjes 2006-2007 dhe 1/5 e bashkërendimit të sezonit të ngrohjes 2004-2005

Të Ardhurat e Lejuara janë llogaritur sipas formulës në vijim:

$$R = R_{bRec} +/- \text{Vlera e Bashkërendimit}$$

Pra përfundimisht, Të Ardhurat e Lejuara për NQ TERMOKOS për sezonin e ngrohjes 2007-2008 janë përcaktuar në vlerën €5,223,761, siq është paraqitur në Tabelën 5.

Tabela 5: Të Ardhurat e Lejuara për NQ TERMOKOS për sezonin e ngrohjes 2007/2008

Të Ardhurat e Lejuara – NQ TERMOKOS Sezoni i ngrohjes 2007 – 2008		In €
R_{bRec}	Të Ardhurat e Lejuara para Bashkërendimit	6,238,095
	Bashkërendimi – sezoni ngrohjes 2006-2007	(721,780)
	Bashkërendimi – sezoni ngrohjes 2004-2005	(292,554)
R	Të Ardhurat e Lejuara	5,223,761

Në përputhje me proporcionin e kostove operacionale fikse dhe variabile para subvencioneve – që janë: përqindja e pjesës fikse 13.85% dhe përqindja e pjesës variabile 86.15%, ndarja e të Ardhurave të Lejuara në pjesen fikse dhe variabile për sezonin e ngrohjes 2007-2008 është si vijon:

Pjesa fikse e të Ardhurave të Lejuara (R_F) €723,319; dhe

Pjesa variabile e të Ardhurave të Lejuara (R_V) €4,500,442.

